



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 534 Akti

Nr. 563 Vendimi

Tiranë, më 21.9.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj

Kryesues

Valbona Sanxhaktari

Anëtare

Genta Tafa (Bungo)

Relatore

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, në datën 21 shtator 2022, në selinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Miranda Konica**, me funksion gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b** i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
Vendimi nr.78, datë 12.12.2017 i Gjykatës Kushtetuese

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, zj. Miranda Konica ka ushtruar funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, ky subjekt i është nënshtruar procesit

të rivlerësimit, *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

2. Në bazë të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, znj. Miranda Konica i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.6.2020 me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Valbona Sanxhaktari, Lulzim Hamitaj dhe Genta Tafa (Bungo). Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Genta Tafa (Bungo).

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 – 33 të ligjit nr. 84/2016; nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 – 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas neneve 40 – 44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me vendimin nr. 1, datë 17.6.2020, vendosi fillimin e hetimit administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme, për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues komisionerin Lulzim Hamitaj. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Komisioni, me anë të postës elektronike, njoftoi subjektin e rivlerësimit se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka filluar procesin e rivlerësimit kalimtar, në përputhje me nenin 179/b të Aneksit të Kushtetutës si dhe të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

6. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit u njoftua me përbërjen e trupit gjykues, të shortuar në datën 15.6.2020 dhe iu kërkua të deklaronte nëse ishte në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

7. Në përgjigje të *e-mail*-it, të dërguar sipas pikës 6 më lart, subjekti i rivlerësimit me anë të postës elektronike deklaroi se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

8. Me anë të shkresës nr. *** prot., datë 8.8.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisioni është njohur me vendimin nr. ***, datë 27.7.2022 “Për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, znj. Miranda Konica”.

9. Komisioni¹ ka kërkuar informacion nga Gjykata Administrative e Apelit nëse ndaj vendimi të KLGJ-së nr. ***, datë 27.07.2022 është ushtruar ankim nga subjekti i rivlerësimit Miranda Konica.

10. Gjykata² Administrative e Apelit Tiranë ka konfirmuar se deri në datën 14.9.2022 nuk është bërë ankim ndaj vendimit të KLGJ-së nr. ***, datë 27.7.2022, nga subjekti i rivlerësimit Miranda Konica.

11. Komisioni³ ka kërkuar nga KLGJ-ja të konfirmojë nëse nga ana e subjektit të rivlerësimit është bërë ankim ndaj vendimit nr. ***, datë 27.7.2022 dhe nëse ky vendim ka marrë formë të prerë.

¹ Shkresa e Komisionit nr. *** prot., datë 12.9.2022.

² Shkresë e Gjykatës Administrative të Apelit nr.*** prot., datë 15.9.2022.

³ Shkresë e Komisionit nr.*** prot., datë 12.9.2022.

12. KLGJ-ja⁴ ka informuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur ankim ndaj këtij vendimi.

II. ARSYET E PËRFUNDIMIT TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

13. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara më lart, konstaton se:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan;
- ii. Procesi i rivlerësimit ndaj saj nuk ka përfunduar me vendim sipas pikës 1 të nenit 58 dhe me një nga masat disiplinore respektive sipas nenit 59, “konfirmimi në detyrë”, të nenit 60, “pezullimi nga detyra dhe detyrimi për të ndjekur programin e trajnimit” dhe të nenit 61, “shkarkimi nga detyra”;
- iii. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar të drejtën për të dhënë dorëheqjen.
- iv. Këshillit i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. ***, datë 27.7.2022, ka vendosur deklarinimin e mbarimit të statusit të magjistratit të znj. Miranda Konica, për shkak të dorëheqjes.
- v. Subjekti nuk ka paraqitur ankim për këtë vendim të KLGJ-së.

14. Neni 65 i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar procedurën që duhet ndjekur për mbarimin e statusit të magjistratit nëpërmjet dorëheqjes⁵.

15. Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon: “1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet. 2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”.

16. Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 43, ka interpretuar, ndër të tjera, lidhjen ndërmjet këtyre dy dispozitave, si vijon: “[...] Neni 56 i ligjit i jep mundësinë subjektit që dorëhiqet brenda afatit 3-mujor, të përfitojë pagesë kalimtare sipas parashikimeve ligjore në fuqi, mundësi të cilën nuk e përfitojnë subjektet që e japin dorëheqjen pas përfundimit të këtij afati. Gjykata thekson se, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës [...]”.

17. Për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e së drejtës së subjektit për t’u dëgjuar, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në rrugë elektronike, më 20.09.2022, ora 15.43, ka njoftuar subjektin, nëse ka vullnetin të marrë pjesë në seancë dëgjimore dhe se fokusi i kësaj seance do të jetë përfundimi i procesit të rivlerësimit në zbatim të nenit G, paragrafi 1 dhe 2 i Aneksit të Kushtetutës.

⁴ Shkresë e KLGJ-së nr.*** prot. datë 21.9.2022.

⁵ 1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. 2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit.

18. Subjekti i rivlerësimit, po në datën 20.9.2022, ora 16:09, me anë të postës elektronike, ka njoftuar Komisionin se nuk dëshiron të marrë pjesë në seancë dëgjimore.

19. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfrytëzuar të drejtën që i njej Kushtetuta dhe ligji për dorëheqje nga statusi i magjistratit.

Ndërprerja e procesit të rivlerësimit, për shkak të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit, sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin G të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 57 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe në nenin 64 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

V E N D O S I:

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Miranda Konica.
2. Ndalimin e emërimit të znj. Miranda Konica si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerëve Publikë, vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në datën 21.9.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim HAMITAJ

Kryesues

Genta TAFA (BUNGO)

Relatore

Valbona SANXHAKTARI

Anëtare

Sekretare gjyqësore

Etmonda Hoxha